

KURS DREJTSHKRIMI PËR GAZETARËT

Duke vënë në jetë Vendimin e Këshillit të Ministrave datë 8.3.1974 «Mbi masat për zbatimin e drejtshkrimit të njëzuar të gjuhës shqipe» Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, në bashkëpunim me Bashkimin e Gazetarëve të Shqipërisë organizuan një kurs drejtshkrimi me gazetarët e kryeqytetit. Kursi u hap me referatin e prof. A. Kostallarit «Drejtshkrimi i njëzuar dhe disa detyra të shtypit tonë në kohën e sotme» (shih për këtë informacionin tonë në «Studime filologjike» nr. 1, 1974, f. 213-215). Mbase u punuan temat «Parimi fonetik dhe zbatimi i tij në drejtshkrimin e shqipes» nga prof. M. Domi, «Parimi morfologjik dhe zbatimi i tij në drejtshkrimin e shqipes» nga B. Beci, «Shqiptimi letrar dhe drejtshkrimi» nga Gj. Shkurtaj, u kalua në zberthimin dhe shpjegimin e rregullave e të çështjeve të tjera të veçanta të drejtshkrimit të shqipes. U punuan temat: «Zanorja e theksuar dhe e patheksuar», «Zanorja ë e theksuar», «Grupe zanoresh dhe diftongje» nga Gj. Shkurtaj, «Zanorja ë e patheksuar» nga E. Lafe, «Shkrimi i fjalëve njësh, ndaras dhe me vizë në mes» nga M. Samara, «Përdorimi i shkronjave të mëdha» nga Xh. Gostura-

ni, «Përdorimi i shkronjave të mëdha në emrat gjeografikë» nga P. Daka. Mbase përfundoi cikli i temave për drejtshkrimin, kursi vazhdoi me një cikël temash mbi çështje gramatikore dhe mbi çështje të terminologjisë, të stilit e të leksikut. U punuan temat «Mbi disa trajta të shumësit të emrave dhe të mbiemrave» dhe «Probleme të normës letrare në sistemin foljor të shqipes» nga S. Dhrimo, «Shkrimi i njëzës së përparme» dhe «Shkrimi i disa pjesëzave dhe para-fjalëve» nga E. Hysa, «Probleme të strukturës sintaksore në gjuhën e shtypit» nga S. Floqi, «Mbi përdorimin e shenjave të pikësimit» nga M. Totoni, «Për njësimin dhe zbatimin e terminologjisë tekniko-shkencore» nga F. Leka. Për të ardhur në ndihmë edhe punonjësve të shtypit në rrethe, ligjëratat e mbajtura në kurs po botohen te revista «Tribuna e gazetarit» duke filluar nga Nr. 1 1974, Kursi u ndoq me shumë interes nga punonjësit e shtypit, të cilët po bëjnë përpjekje të vazhdueshme për përvetësimin e drejtshkrimit të gjuhës shqipe dhe të normës letrare kombëtare.

E. Lafe